



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA STUDIMI “LANDI I BAVARISË”, VITI AKADEMIK 2025-2026

Landi i Bavarisë ka shpallur aplikimin për kurset verore të gjuhës gjermane, në institucionet e arsimit të lartë bavarez për vitin akademik 2024 – 2025. Bursat përfshijnë tarifat e shkollimit, strehimin dhe ushqimin.

Aplikantët duhet të jenë studentë dhe akademikë të rinj nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Sllovenia dhe Ukraina. Aplikantët duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

- Të kenë aftësi mesatare në gjuhën gjermane (niveli B1);
- Të kenë përfunduar dy semestre në një institucion të arsimit të lartë në vendin përkatës;
- Të kenë rezultate të kënaqshme akademike;
- Të kenë shtetësinë e njërit prej vendeve të sipërpërmendura.

Afati i fundit i aplikimit është data 23 mars 2025 dhe duhet të kryen vetëm përmes formularit online në faqen BAYHOST – <https://www2.daad.de/deutschland/stipendium/datenbank/en/21148-scholarship-database/?detail=10000366>.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS